



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02. Nr. 2305 /2018

Dt: 14.03.2018

Duke u bazuar në, Ligjin e Punës nr 03/L-212 neni 8, Udhëzimin administrativ për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik nr 14/2011, Komuna Hani i Elezit Shpall këtë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës:

- Roje pylli (Sektori i Pylltarisë)

Kategoria dhe grada : (koeficienti 4.5)

Kohëzgjatja e kontratës: periudhë të pa caktuar, periudha provuese 6 muaj

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- **Detyra 1:** Angazhimi i drejtpërdrejt në mbrojtje të pyllit dhe resurseve natyrore
- **Detyra 2:** Bashkëpunimi me Zyrtarin për monitorim dhe mbrojtje të pyjeve si dhe me rojen e pyllit me të cilët kufizohet
- **Detyra 3:** Parashtrimi i fletëparaqitjeve për vjedhje pylli, dhënia e deklaratës Zyrtarit për monitorim dhe mbrojtje të pyjeve për përpunim të mëtutjeshëm
- **Detyra 4:** Përfaqësimi i lëndëve-fletëparaqitjeve për vjedhje pylli në gjykatë në cilësi të dëshmitarit
- **Detyra 5:** Evidentimi i të dhënave në ditarin e punës dhe librin e cungave
- **Detyra 6:** Mbrojta obligative e të gjitha shenjave në pyll (parcelave-reparteve, nën parcelave)
- **Detyra 7:** Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Zyrtarit për monitorim dhe mbrojtje të pyjeve dhe drejtorit përkatës të cilëve edhe i'u përgjigjet
- **Detyra 8:** Raporton te Zyrtari për monitorim dhe mbrojtje të pyjeve

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte

- **Shkollimi i mesëm**
- **Përvoj pune** (e preferuar)
- **Aftesi të mira komunikimi**

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Punës si dhe Udhëzimin administrativ për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik nr 14/2011 .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Formularët e aplikimit mund të merren në qendrën për shërbim të qytetarëve , çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në qendrën për shërbim të qytetarëve në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe çertifikata tjera nëse posedon.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.



Kryetari i Komunës
Rufli Suma

[Handwritten signature]